



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
ADMINISTRATORI

Nr. 92 Prot.

Tiranë, më 19 /01/2024

URDHËR

Nr. 10, Datë 19 /01/2024

MBI

**“PAGESËN E TARIFËS SË SHKOLLIMIT PËR CIKLIN E PARË DHE TË DYTË
TË STUDIMEVE PËR VITIN AKADEMIK 2023 - 2024 NË UNIVERSITETIN E
ARTEVE”**

Bazuar në nenin 3, pika 3, gërma (ç), në nenin 51 dhe 52, në nenin 98, pika 2, gërma (c), të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 113, pika 3 të ligjit nr.44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 27, datë 29.12.2017 “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.778, datë 26.12.2018 “Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr.288, datë 21.05.2018 të Këshillit të Ministrave ...”, Vendimin e Bordit të Administrimit nr.15, datë 13.06.2019 “Mbi miratimin e tarifave të ciklit të dytë të studimeve për studentët mbetës dhe përsëritës në fakultetet e Universitetit të Arteve”, Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 25, datë 13.07.2020 “Mbi zbatimin e Vkm nr.778, për përfitim të reduktimit të tarifës së shkollimit, në Universitetin e Arteve” dhe Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 13, datë 15.03.2023 “Mbi miratimin e tarifave të konkurrimit, tarifës së regjistrimit, tarifës së shkollimit program i parë studimi, si dhe tarifës së shkollimit program i dytë studimi, për të gjitha programet e studimit të ofruara nga Fakultetet e Universitetit të Arteve, për vitin akademik 2023-2024”,

URDHËROJ:

1. Pagesën e tarifës së shkollimit për ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, për vitin akademik 2023-2024, në Universitetin e Arteve.
2. Studentët e ciklit të parë të studimeve Bachelor, në fakultetet e UART, të kryejnë pagesën vjetore të tarifës së shkollimit deri në datën 29.01.2024.
3. Studentët e ciklit të dytë të studimeve Master, në fakultetet e UART, të kryejnë pagesën vjetore të tarifës së shkollimit të ndarë në dy këste, kësti i parë të paguhet në masën 50% të shumës totale deri në datën 29.01.2024 dhe kësti i dytë të paguhet deri në datën 30.04.2024.

4. Mandat pagesa gjendet në faqen zyrtare të UART.
5. Ky urdhër të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve.
6. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhëri, sekretaritë mësimore pranë fakulteteve të Universitetit të Arteve dhe Drejtoria Ekonomike.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ADMINISTRATOR

Alma Sinana

